

RAPORT I SHKURTËR MAKROFISKAL

Performanca e Buxhetit të Shtetit 2025–2026 · Korrik 2026

Mesazhet Kryesore

- Të ardhurat arritën 410.6 miliardë lekë (+12.2%, 5% mbi plan). Deficiti u rrit megjithatë me 59.5%, në 52.8 miliardë lekë, pasojë e një politike fiskale më ekspansive, jo e dobësimit të të ardhurave.
- Tatimi mbi Fitimin mbetet dobësia kryesore (-5.4 miliardë lekë nën plan) dhe kërkon analizë sektoriale të menjëhershme për të dalluar riinvestim privat nga ngushtim marzhesh.
- Investimet publike kanë efekt ekonomik dukshëm më të lartë (deri 2.5x) se transfertat sociale, lek për lek, pa nënkuptuar reduktim të mbrojtjes sociale.
- Pensionet janë të qëndrueshme aktualisht, por presioni demografik afatgjatë kërkon zgjerim të bazës së kontribuesve brenda dekadës.
- Shqipëria ka deficit nën mesataren rajonale, por borxh publik mbi mesataren, çka e bën cilësinë e shpenzimit publik kritike.


Treguesit Kryesorë

Tregues	2025	2026	Ndryshimi
Të ardhurat publike (mln lekë)	366.060	410.607	+44.548 (+12.2%)
Shpenzimet publike (mln lekë)	332.967	357.814	+24.847 (+7.5%)
Deficiti buxhetor (mln lekë)	33.093	52.793	+19.700 (+59.5%)
Fondet speciale (mln lekë)	127.089	137.120	+10.031 (+7.9%)

Tabela 1. Treguesit kryesorë makrofiskalë, 2025–2026. Burimi: Ministria e Financave, përpunim ALTAX.

Rekord të Ardhurash, por edhe Rekord Shpenzimesh


Krahasim 2025 – 2026 (milionë lekë) | Burimi: Ministria e Financave, përpunim ALTAX



Grafiku 1. Të ardhurat, shpenzimet dhe deficiti, 2025 vs 2026 (milionë lekë).

Investimet Nxisin më Shumë Rritje se Transfertat Sociale, Lek për Lek

Efekti kumulativ 2-vjeçar në PBB për 1 lek të shpenzuar | Modelim indikativ ALTAX



Grafiku 2. Multiplikatori fiskal — investime publike kundrejt transfertave sociale.

Rreziqet Kryesore për Gjashtëmujorin II

Rreziku Kryesor	Probabiliteti	Ndikimi
Dobësim i mëtejshëm i Tatimit mbi Fitimin	I lartë	I lartë
Vonesa në financimin e huaj për investime	I lartë	Mesatar
Rritje e kostonë ndërkombëtare të borxhit	Mesatar	I lartë
Rritje e detyrimeve pensionale afatgjata	Mesatar	I lartë

Tabela 2. Rreziqet fiskale me probabilitet dhe ndikim më të lartë. Burimi: përpunim ALTAX.

Rekomandimet Kryesore

#	Rekomandimi	Afati
1	Analizë sektoriale e menjëhershme e Tatimit mbi Fitimin	Gjashtëmujori II 2026
2	Përsheptim i disbursimit të projekteve me financim të huaj	Gjashtëmujori II 2026
3	Sistem monitorimi kosto-rezultat për investimet publike	2026–2027
4	Analizë aktuariale zyrtare e qëndrueshmërisë së pensioneve	2027
5	Politika aktive punësimi lidhur me shpenzimet sociale	2026–2027

Tabela 3. Rekomandimet strategjike prioritare. Burimi: përpunim ALTAX.

Konkluzion

Buxheti 2026 shënon kalim drejt një politike fiskale më aktive me rritje të njëkohshme të të ardhurave, investimeve dhe mbështetjes sociale. Cilësia e kësaj performance do të varet nga aftësia për ta shndërruar rritjen fiskale në rritje ekonomike afatgjatë, jo vetëm nga niveli i mbledhjes së të ardhurave.

ALTAX — Qendër për Studime Fiskale dhe Politika Publike

Ky është përmbledhja e shkurtër e Raportit të Plotë Makrofiskal 2025–2026. Për analizën e detajuar, tabelat plotësuese dhe metodologjinë, referojuni raportit të plotë.